

19.02.2022
Ora 11:11

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së “RTSH Shkodra”, “Euro Balkans News”, “TV Klan” dhe “MCN TV” për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, E.Meta**
- **Parti Politike:** **LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Sot në seancë kemi 6 çështje në rendin e ditës. Projektvendimi për miratimin e vëzhguesve për disa media. Projektvendimin për miratimin e vëzhguesve për disa organizata të shoqërisë civile. Projektvendim për një ndryshim në vendimin nr. 9 dt.25.01.2022 të Komisionerit Shtetëror. Projektvendim për dhënie autorizim për ndryshimin e vendndodhjes së dy qendrave të votimit në Shkodër dhe projektvendim për një ndryshim në vendimin nr.12, 26.01.2022 i Komisionerit Shtetëror, për miratimin e materialeve zgjedhore që do të përdoren për zgjedhjet e pjesshme.

Atëherë, fillojmë me pikën e parë që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës për caktimin e vëzhguesve nga disa media “RTSH Shkodra”, “Euro Balkans News”, “TV Klan” dhe “MCN TV”.

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.02.2022*

Z. Y. Merkaj: “RTSH Shkodra”, ka paraqitur kërkesën për akreditimin e tetëmbëdhjetë gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

“Euro Balkans News shpk”, ka paraqitur kërkesën për akreditimin e tridhjetë e katër gazetarëve dhe operatorëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

“TV KLAN sh.a.” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e tridhjetë e gjashtë gazetarëve dhe operatorëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Si dhe “MCN TV” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e tetëmbëdhjetë gazetarëve dhe operatorëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesat e paraqitura respektojnë afatin e përcaktuar nga neni 6, pika 5 të Kodi Zgjedhor dhe subjektet gëzojnë të drejtën për të paraqitur vëzhgues në zgjedhjet për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Bashkëlidhur keni vendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive dakord?! Atëherë miratojmë: Kërkesën e tetëmbëdhjetë gazetarëve dhe operatorëve të Medias “RTSH Shkodra”; Kërkesën e Medias “Euro Balkans News” për tridhjetë e katër gazetarëve dhe operatorëve;

Kërkesën e “TV KLAN” për akreditimin e tridhjetë e gjashtë gazetarëve dhe operatorëve;

Kërkesën e “MCN TV” për akreditimin e tetëmbëdhjetë gazetarëve dhe operatorëve.

Vendimi nr. 86

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



19.02.2022
Ora 11:13

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së “Report TV”, “Agjencia Telegrafike Shqiptare”, “TV1- Channel”, “Syri TV”, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, E.Meta**
- **Parti Politike:** **LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër!

Z. Y. Merkaj: “Report TV”, ka paraqitur kërkesën për akreditimin e dyzet e pesë gazetarëve.

“ATSH”, ka paraqitur kërkesën për akreditimin e njëmbëdhjetë gazetarëve dhe operatorëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

“TV1 Channel” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e trembëdhjetë gazetarëve dhe operatorëve. si dhe,

“Syri TV” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e dyzet gazetarëve dhe operatorëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesat e paraqitura respektojnë afatin e përcaktuar nga neni 6, pika 5 të Kodi Zgjedhor si dhe gëzojnë të drejtën për të paraqitur

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.02.2022*

vëzhgues në zgjedhjet për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive dakord?! Atëherë miratohet: Kërkesa për akreditimin e njëmbëdhjetë gazetarëve dhe operatorëve të “Report TV”; Kërkesa e “ATSH” për akreditimin e njëmbëdhjetë gazetarëve dhe operatorëve; Kërkesa e “TV1 Channel” për akreditimin e trembëdhjetë gazetarëve dhe operatorëve; Kërkesa e “Syri TV” për akreditimin e dyzet gazetarëve dhe operatorëve.

Vendimi nr. 87

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



19.02.2022
Ora 11:15

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së Shoqatës për Kulturë Demokratike dhe Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Insitucione të Konsoliduara për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, E.Meta**
- **Parti Politike:** **LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ** **KRIK**


Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër!

Z. Y. Merkaj: Shoqata për Kulturë Demokratike, ka paraqitur kërkesën pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për akreditimin e gjashtëmbëdhjetë vëzhguesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre, vëzhguesit janë afatshkurtër.

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e dyzetë e gjashtë vëzhguesve afatgjatë. Kërkesat e paraqitura respektojnë afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5 të Kodit Zgjedhor, si dhe gëzojnë të drejtën të caktojnë vëzhgues për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive, dakord?! Atëherë miratohet:

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.02.2022*

Kërkesa e Shoqatës për Kulturë Demokratike, për akreditimin e gjashtëmbëdhjetë vëzhguesve, përfaqësues të kësaj shoqate, si dhe kërkesa e Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), për akreditimin e dyzetë e gjashtë vëzhguesve, përfaqësues të kësaj organizate.

Vendimi nr. 88

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



19.02.2022
Ora 11:16

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 9, datë 25.1.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e sasisë së vulave rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit që do të prodhohen për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, E.Meta**
- **Parti Politike:** **LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër!

Z. Y. Merkaj: Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 11, datë 28.12.2020, ka përcaktuar prodhimin e vulës rezervë me tekst unik për zëvendësimin e vulës së KQV-së apo vulës së Kryetarit të KQV-së, të nxjerrë nga përdorimi. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 9, datë 25.01.2022, ka vendosur të prodhojë njëqind vula reserve për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022. Duke vlerësuar reduktimin e kërkesave buxhetore, miratuar me vendim nr. 59, datë 10.02.2022, kemi propozuar që kjo sasi të ulet në 50% duke vlerësua dhe riskun gjykohet që, kjo sasi të jetë e mjaftueshme zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, faleminderit!

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.02.2022*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive, dakord?! Atëherë miratohet: Ndryshimi i pikës 1 të vendimit nr. 9, datë 25.1.2022, të Komisionerit Shtetëror, duke vendosur: Për zgjedhjet e pjeshme vendore të datës 6 Mars 2022, të prodhohen pesëdhjetë vulat rezervë të KQV-së.

Vendimi nr. 89

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



19.02.2022
Ora 11:17

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendodhjes së dy qendrave të votimit në bashkinë Shkodër, për zgjedhjet e pjeshme vendore të datës 6 mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, E.Meta**
- **Parti Politike:** **LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ** **KRIK**


Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër!

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 47, datë 7 shkurt 2022 ka miratuar vendndodhjen e disa qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022. Nga kryetari i Bashkisë Shkodër ka ardhur propozimi për ndryshimin e vendndodhjes së dy qendrave të votimit. Përkatësisht QV nr. 0299 dhe QV nr. 0299/1, i propozohet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që të ndryshohet vendndodhja e tyre pasi janë më afër zonës zgjedhore ku do të zhvillohet procesi i votimit, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Kjo shkon nga Shkolla “ABC”, në Shkollën “Salo Halili”, kështu është?! KZAZ-ja ka dhënë të gjithë miratimin për këtë ndryshim, të shtatë anëtarët? Dakord! Atëherë miratohet ky ndryshim!

Vendimi nr. 90

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU



19.02.2022
Ora 11:18

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 12, datë 26.1.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e materialeve zgjedhore që do të përdoren për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, E.Meta**
- **Parti Politike:** **LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, me pikën e fundit!

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka miratuar me vendimin nr. 12, datë 26.01.2022 materialet zgjedhore që do të përdoren për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022. Ndër të tjera ka përcaktuar dhe kodet rezervë që do të përdoren për mbylljen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore. Në këtë vendim është përcaktuar që kodet që do të përdoren do të jenë ato të miratuara me vendimin nr. 8, datë 12 janar 2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Duke parë se gjendja në magazinë është më e vogël se kërkesat që kemi për të përdorur në zgjedhjet e datës 6 Mars 2022, i propozohet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që të ndryshohet

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.02.2022*

vendimi duke përdorur kodet e sigurisë të cilat janë përdorur në datën 25 Prill 2021, miratuar me vendim nr. 35, datë 16.12.2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike?! Nuk kemi! Dakord! Atëherë miratohet edhe ky projektakt sipas draftit të propozuar. Çështje të tjera në rendin e ditës nuk kemi?! Përfaqësues të partive, çështje të tjera jashtë rendit të ditës? Nuk kemi! Faleminderit, ditë të mbarë!

Vendimi nr. 91

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

